



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 16-9762/15
Kaçanik, 01.04.2015

Në bazë të nenit 12 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare nr. 03 L/040, të neneve, 100, 101 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Administrative 02/L028 i datës 22 korrik 2005, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 01.04. 2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS
KAÇANIK Nr. 01-463-11 TË DATËS 20 SHKURT 1986

1. Me këtë Vendim, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Kaçanik 01-463-11 i datës 20 shkurt 1986, që ka të bëjë me dhënjën në shfytëzim të përhershëm pa kompensim, Organizatës Punuese "Saniteks" nga Klladusha e Madhe, pasurinë e paluajtshme sipas fletës poseduese nr. 86 pk.nr.888 me kulturë, ndërtesë dhe oborr me sipërfaqe prej 0.45.31 ha, pk nr.889 me kulturë mal i klasit të tretë me sipërfaqe 0.88,63 ha, pk nr. 890 me kulturë livadhë i klasit 6 me sipërfaqe 2.09.99 ha dhe pk nr.891 kultura livadh i kl 6 me sipërfaqe prej 0.51.89 ha e cila gjindet në KK Kaçanik, pronare e së cilës është komuna e Kaçanikut.

2. Me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01-463-11 të datës 20 shkurt 1986, pasuria e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim të përhershëm Organizatës Punuese "Saniteks" nga Klladusha e Madhe, e përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, i kthehet në pronësi, pronarit- Komunës së Kaçanikut.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

4. Ky vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës së Kaçanikut.

Arsyetim

Bazuar në arsyeshmerinë e Kryetarit të Komunës të dhënë si në Propozim Vendimin 01Nr. 16-9762/15 prej datës 23.03.2015 për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 01-463-11 të datës 20 shkurt 1986, si dhe në Informatën e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit mbi ecurinë e pronës së përcaktuar të paluajtshme, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 01.04.2015, vlerësoj se janë plotësuar kushtet që prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim OP të përcaktuar si në pikën 1. të Vendimit, t'i kthehet në pronësi komunës së Kaçanikut, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
3. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Kryetari i Komunës

01 Nr. 16-9762/15

Kaçanik, 23.03.2015

Kryetari i Komunës së Kaçanikut , bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 58 pika d dhe pika h , bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut neni 3, neni 6 pika h dhe neni 73 pika 2 :

PROPOZON

Që Kuvendi Komunal në bazë të Ligjit të procedurës Administrative neni 100, neni 101, neni 102 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës së Kaçanikut të e merr këtë :

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

NR.01-463-11 të dt.20 shkurt 1986

I

Me këtë Vendim , Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.01-463-11 i dt.20 shkurt 1986 i aprovuar nga Kuvendi i Komunës , që ka të bëjë me dhënjën në shfrytëzim të përhershëm të pasurisë së paluajtshme Organizatës Punuese “SANITEKS” nga Klladusha e Madhe pa kompenzim .

II

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes nga Kuvendi i Komunës Kaçanik.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit , Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

IV

Me këtë Vendim njoftohen : Drejtoria e Urbanizmit,Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Arkivi i Komunës .

ARSYETIM :

Bazuar në informatën e Drejtorisë së Urbanizmit , Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të dt. 18.03.2015 lidhur me rrjedhën apo historikun e ngastrave kadastrale nr. 888,nr.889,nr.890, nr.891 shihet se për këto ngastra kadastrale janë marrur një mori vendimesh .

Fillimisht nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut me dt. 30.05.1966 objekti i ndërtuar në vitet e 50-ta në këto ngastra i është dhënë në shfrytëzim Spitalit të përgjithshëm në Prishtinë dhe atë me Vendimin nr. 01-2183/1 dt. 30.05.1966.

Pastaj me dt. 30.12.1985 me Vendimin e Kuvendit Komunal të Kaçanikut Nr. 01-415-4 , Kuvendi i Komunës së Kaçanikut hyn në investime të përbashkëta rreth bashkimit të punës dhe mjeteve me OP "Saniteks" nga Klladusha e Madhe , Republika e Bosnjes për ndërtimin e objekteve prodhuese në territorin e Komunës së Kaçanikut .

Me dt. 20.02.1986 me Konkluzionin Nr. 01-463/11, nga Kuvendi i Komunës Kaçanik , i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm , pasuria e paluajtshme Organizatës Punuese "Saniteks" në bazë të fletës poseduese nr. 86 dhe atë :

-ngastra kadastrale nr.888, me kulturë ndërtesë dhe oborr me sip. prej 0.45.31 ha

-ngastra kadastrale nr.889. me kulturë mal i kl.të III-të me sip. prej 0.88.63 ha

-ngastra kadastrale nr. 890, me kulturë livadh i kl.6 me sip. prej 2.09.99 ha

-ngastra kadastrale 891 , me kulturë livadh i klasit 6 , me sip. prej 0.51.89, pronë e cila gjendet në Z.K. Kaçanik , pronë e Kuvendit të Komunës Kaçanik.

-Në vitin 1993, Kuvendi i Komunës Kaçanik në kohën e masave të dhunshme të aplikuara nga pushteti serb , ka lejuar dhënien në shrytëzim të përkohshëm të paisjeve të

Organizatës Punuese " SANITEKS" në Kaçanik , Industrisë Kimike "Nevena " Leskovc.

Me Vendimin Nr. 36-289 ,të dt. 20.08.1993 të Këshillit Komunal të Komunës së Kaçanikut , poashtu në kohën e masave të dhunshme të aplikuara nga pushteti serb , ky objekt i Organizatës Punuese " SANITEKS" nga Klladusha e Madhe i jepet në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Pas luftës objekti dhe ngastrat kadastrale me Vendim të Kuvendit Komunal të Kaçanikut janë shfrytëzuar për nevoja të Trupave Mbrojtëse të Kosovës e deri në transformimin e tyre në Forcat e Sigurisë së Kosovës në vitin 2009.

Fakt tejet me rëndësi është ajo se anjherë për këto ngastra kadastrale nuk ka pasur ndryshime kadastrale , ku deri me sot ende këto ngasta evidentohen në emër dhe pronësi të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut .

Për Komunën e Kaçanikut është me rëndësi fakti se Organizata Punuese ” Saniteks” që nga vitet e 90-ta nuk është as në posedim e as në shfrytëzim të objektit dhe ngastrave kadastrale. Duke u bazuar në Ligjin mbi Mardhënjet Themelore Juridike Pronësore të 30.01.1980 i cili atë kohë ka qenë fuqi , neni 70 i këtij Ligji thotë :

Posedimin e patundshmërive e ka çdo person që ushtron drejtëpërdrejt zotërimin faktik të patundshmërisë.

Gjithashtu neni 20 i këtij Ligji thotë se ekzistojnë mënyra të ndryshme për fitim e pronësisë . E drejta e pronësisë- neni 20 fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetërorë në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.

Në bazë të veprimit juridik, neni 33 e drejta e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librat publik , ku në rastin konkret Komuna e Kaçanikut që nga themelimi i librave dhe operatit kadastral është e regjistruar në emër dhe pronësi të Kuvendit Komunal Kaçanik.

Gjithashtu arsyeja se pse me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut Nr. 01-463/ 11 i dt. 20.02.1986 iu është dhënë në shfrytëzim ,ka pushuar që nga vitet e 90- ta kur OP” “ Saniteks “ ka pushuar së vepruari në objektin dhe ngastrat e lartëcekura ,pra qëllimi dhe kushtet e dhënjes në shfrytëzim kanë pushuar.

Neni 44 i Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridike Pronësore thotë se E drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësinë shoqërore . Në rastin konkret edhe objekti edhe ngastrat kadastrale kanë qenë dhe ende janë në pronësi shoqërore .

Neni 46 i këtij Ligji thotë se: E drejta e pronësisë pushon edhe me braktisje, në rastin tonë konkret këto janë braktisur nga OP” Saniteks “ që nga vitet e 90-ta .

Sendet e braktisura kalojnë në pronësi shoqërore në momentin e braktisej se tyre.

Andaj duke u bazuar në këto që u theksuan më lartë Kuvendi i Komunës së Kaçanikut vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Departamenti i Urbanizimit, Kadastrit
dhe Mbrojtjes së Mjedisit

06. NR. 350 - 9438 / 15

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE:			
PËR/ZA/TO:		Besim Ilazi, Kryetar i Komunës,	
CC:		Fitore Daci-Krivanjeva, Avokate publik,	
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:		Fatos Koxha, Përgjegjës në DUKMM	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Informatë	
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	
Br. kancelarije:	44	Kucni:	Administrata Komunale
Room No.:		Extension:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			X ☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			☐
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE			☐
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS			☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS			☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION			☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED			☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED			☐
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN			☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE			

Në bazë të kërkesës të Kryetarit të Komunës, lidhur me historiatin e ngastrave kadastrale 888, 889, 890, 891, të evidentuara fletën poseduese nr. 86, në Zonën Kadastarel Kaçanik, lokacioni ku është i ndërtuar ish Senatoriumi – reparti për sëmundjet e eshtrave dhe sëmundjet e kraharrorit, ky organ në bazë të dokumentacionit ekzistues në arkivin komunal, jep këtë raport:

1. Objekti i cili është ndërtuar viteve të 50-ta, i është dhënë në shfrytëzim Spitalit të përgjithshëm në Prishtinë, me Vendimin Nr.01-2183/1, të marrë nga Kuvendi i Komunës Kaçanik me datën 30.05.1966. Ky objekt me një destinim të tillë për shëndetësi ka funksionuar deri në vitin 1972 dhe më pastaj nuk është shfrytëzuar për asnjë qëllim.
2. Në vitin 1985, respektivisht me 30.12.1985, me Vendimin Nr.01-415- 4, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, ka hy në investime të përbashkëta rreth bashkimit të punës dhe mjeteve me OP "SANITEKS" nga Velika Klladusha, Republika e Bosnjës e Hercegovinës, për ndërtimin e objekteve prodhuese në territorin e Komunës së Kaçanikut (në këtë rast adaptimi i objektit ekzistues për nevoja të repartit të ri prodhues të materialit sanitar për OP "SANITEKS").
3. Më datën 20.02.1986, me Konkluzionin Nr.01-463/11, nga Kuvendi i Komunës Kaçanik, i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm, pasuria e paluajtshme në bazë të fletës poseduese nr. 86,dhe atë:
 - ngastra kadastrale nr.888, me kulturë : ndertesë dhe oborr me sipërfaqe 0.45.31 ha,
 - ngastra kadastrale nr.889, me kulturë: mali kl. III-të, me sipërfaqe 0.88.63 ha,
 - ngastra kadastrale nr.890, me kulturë: livadh i kl. 6, me sipërfaqe 2.09.99 ha, dhe
 - ngastra kadastrale nr.891, me kulturë: livadh i kl. 6, me sipërfaqe 0.51.89, pronë e cila gjendet në Z.K-le Kaçanik , pronë e Kuvendit Komunës Kaçanik.

Ndryshimet kadastrale –bartja e pronës nuk është bërë nga sektori i gjeodezisë dhe kadastrit.

4. Në vitin 1993, Kuvendi i Komunës Kaçanik në kohën e masave të dhunshme të aplikuara nga pushteti serb, ka lejuar dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pajisjeve të OP "SANITEKS" në Kaçanik Industrisë kimike " Nevena " Leskovac.
5. Me Vendimin Nr.36-289, të datës 20.08.1993, të Këshillit komunal të komunës së Kaçanikut, poashtu në kohën e masave të dhunshme të aplikuara nga pushteti serb, ky objekt i OP "SANITEKS", nga Velika Kladusha, i jepet në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme të Sërbisë.

Në vitet pas luftës ky objekt është shfrytëzuar për nevoja të TMK-së deri në transformimin e tyre në FSK në vitin 2006.

Në momentin e shkrimit të kësaj Informate, kjo pronë evidentohet si pronë e Kuvendit Komunës Kaçanik.

Me respekt.

Na osnovu člana 4 st.2 Zakona o prometu nepokretnosti, ("Službeni list SAPK", br.45/81) i člana 228 Statuta Opštine Kačanik ("Službeni list SAPK", br.48/85), Skupština opštine Kačanik, na zajedničkoj sednici svih veća, održanoj 20. februara 1986. godine, donosi

Z A K L J U Č A K

O DAVANJU NA TRAJNO KORIŠĆENJE NEPOKRETNE IMOVINE RO "SANITEKS" IZ VELIKE KLAĐUŠE BEZ NAKNADE

I

Daje se na trajno korišćenje RO "Saniteks" iz Velike Kladuše nepokretna imovina po posedovnom listu br.86 k.p.br.888 pod kulturom zgrada i dvorišta u površini od 0,45,31 ha, k.p.br. 889 pod kulturom šuma 3 klase u površini od 0,88,63 ha, kat.parc. br.890 pod kulturom livada 6 klase u površini od 2.09,99 ha i kat. parc. br.891 pod kulturom livada 6 klase u površini od 0.51,89 ha koja se nalaze u KO Kačanik Šajji je korisnik Skupština opštine Kačanik.

II

Davanje na trajno korišćenje nepokretne imovine opisano u tački I ovog zaključka da-je se bez naknade i bez pravo otudjivanja i sastoji se:

- nepokretna imovina koja prema Odluci o građevinskom zemljištu Skupštini opštine Kačanik iznosi 12.469.000 dinara,
- zgrade takozvanog "Letovaliste" na bruto površinu CCA 1100 m² u ~~knjižovno~~ vrednost od 32.200.000 dinara.

III

Učešće Skupštine Opštine Kačanik prema samoupravnom sporazumu o udruživanju rada i sredstava, osim nepokretnosti naknade-
ni u tački I i II ovog zaključka obezbeđuje i iznos sredstava budžetom Opštine za 1986. godinu ito:

1. Za osnivaška ulaganja 2.500.000 dinara,
2. Za ostala ulaganja 1.000.000 dinara.

IV

O sprovođenju ovog zaključka staraće se Odeljenje za privredu i finansije, odnosno Imovinsko-pravna služba SO Kačanik.

V

Ovaj zaključak stupa na snagu danom donošenja.

Në bazë të nenit 4.par.2. të Ligjit mbi qarkullimin e paluejtshmërive(Fleta zyrtare KAKM,nr.45/81) dhe nenit 228 të statutit të Komunës Kaçanik (Fleta zyrtare KAKM,nr.48/85,Kuvendi komunal Kaçanik në seancën e përbashkët të të gjitha kshillave të mbajtur me 20 shkurt 1986 viti solli :

KONKLuzion

MBI DHËNJEN NË SHFRYTZIM TË PËRHERSHËM TË PASURISË SË
PALUAJTSHME OP" SANITEKS" NGA KLLADUSHA E MADHE PA KOMPENZIM

I

I ipet në shfrytzim të përhershëm OP "Saniteks" nga Klladusha e Madhe pasuria e paluajtshme sipas fletës poseduese nr.86.pk.nr.888 kultura ndërtesë dhe oborr me sipërfaqe prej 0,45,31 ha.pk.nr.889 kultura mal I kl.së tretë me sipërfaqe 0,88,63 ha.pk.nr.890 kultura livadh I kl 6 me sipërfaqe 2,09.99 ha dhe pk.nr.891 kultura livadh kl 6 me sipërfaqe 0,51.89 ha e cila gjendet në kk Kaçanik pronarë e së ciles është Komuna Kaçanik

II

Dhenja në shfrytzim të përhershëm e pasurisë së paluajtshme e përshkruar në nenin I të këtij konkludimi jepet pa kompenzim dhe pa te drejt tëhuajsimi dhe pëbehet nga:

--pasuria e paluajtshme e cila sipas vendimit të Kuvendit Komunal Kaçanik mbi token ndertimore është 12.469,000 dinarë,

--ndërtesa e ashtuquajtur "Pushimore" me bruto sipërfaqe CCA 1100m²,vlera 32,20,000 dinarë

III

Pjesmarrja e Kuvendit Komunal sipas marrveshjes vetqeverisëse mbi bashkimin e punës dhe mjeteve,përveç paluajtshmërive të shenuara në nenin I dhe II të këtij konkludimi siguron shumën e mjeteve me buxheti komunal për vitin 1986 edhe ate:

- 1.Për investim themelues 2.500,000 dinarë
- 2.Për investime tjera 1.000.000 dinarë

IV

Për ekzekutimin e këtij konkludimi do të kujdeset seksioni për ekonomi e financa,gjegjisht shërbimi pronsoro juridik i KK Kaçanik

V

Ky konkludim hynë në fuqi ditën e nxjerrjes.

VI

Me hyrjen në fuqi të këtij konkludimi mbaron vlefshmeria e Vendimit mbi dhenjen në shfrytzim të ndërtesës "Pushimorja" në Kaçanik-Spitalit të përgjithshëm në Prishtinë nr.01-2183/1 30 maj 1986 viti

Nr.01-463-11

Kaçanik 20.shkurt 1986

KK Kaçanik

Kryetari
Murtez Mema

KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

01 Nr. 132 - /01

Kaçanik, 01.11. 2001

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në bazë të nenit 4 të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së palujtshme ("Gazeta zyrtare e KSAK" nr.45/81), nenit 44.2 të Rregullores së UNMIK-ut Mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës si dhe nenit 16 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e vet të mbajtur më 31.10.2001, muarr këtë

V E N D I M

I.

I ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompenzim, në afat prej 10 (dhjetë) vitesh TMK-së – Zona e VI e Mbrojtjes – Brigada 362 "Agim Bajrami" në Kaçanik, pasuria e palujtshme sipas fletës poseduese 86, parcela kadastrale 888, me kulturë e paplleshme-shtëpi e oborr në sipërfaqe prej 0.45.31 ha, parc.kad.889 me kulturë mal i kl.3 në sipërfaqe prej 0.88.63 ha, parc.kad.890, me kulturë livadh i kl.VI në sipërfaqe prej 2.09.99 ha dhe parc.kad.891, me kulturë livadh i kl.VI në sipërfaqe prej 0.51.89 ha ose në sipërfaqe të përgjithshme prej 3.95.82 ha, K.Kat.Kaçanik, e evidentuar si pasuri shoqërore e Kuvendit të Komunës Kaçanik

II.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi çfuqizohet Përfundimi mbi dhënjën Në shfrytëzim të përhershëm të patundshmërisë OP "Saniteks" nga Velika Klladusha o1 Nr.463-11 prej 20.02.1986 dhe aktvendimi mbi dhënjën në shfrytëzim të përkohshëm MPB të Serbisë – Shtabit të njësive speciale në Kaçanik o1 Nr.361-289 Prej 08.09.1993.

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrje.



Kryetari,
Fahri Çaka